 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	1 / 24

KREU 1

Neni 1

Objekti i rregullores

Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të dytë përcakton rregullat e funksionimit të këtyre programeve dhe të marrëdhënieve që krijohen ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në veprimtaritë e tyre. Ajo përcakton objektin e programeve të studimit të ciklit të dytë, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, raportet ndërmjet tyre, rregullat për pranimin e studentëve, mësimdhënien, kërkimin, praktikën, vlerësimin, diplomimin dhe sanksionet në rast shkeljeje të rregullores.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të dytë të Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) mbështetet në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.10307, datë 22.07.2010, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, në licencën e dhënë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës nr. 14, datë 03.04.2008 “Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë”, në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.nr.15, datë 04.04.2008, “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, si edhe në statutin dhe Rregulloren themelore të këtij Institucioni.

Neni 3

Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë misionin dhe objektivat kryesorë të programeve të studimit të ciklit të dytë, të përcaktuar nga departamentet, si njësi bazë dhe të rregullojë aspekte të krijimit, organizimit, drejtimit, ofron kryerjen e studimeve e të humultimeve akademike e kërkimore në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.


Neni 4

Përkufizime

Në rregullore, me shkurtime e mëposhtme kuptohen:

Shkolla e Lartë :Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)

Rektorati :Rektorati i Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	2 / 24

Senati	:Senati i Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)
Fakulteti	:Fakultetet e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), të cilat ofrojnë programe studimi të ciklit të dytë.
TOEFL	:Test of English as a Foreign Language
IELTS	:The International English Language Testing System
ECTS	:European Credit Transfer Systems
CGPA	:Cumulative Grade Point Average (Mesatarja e përgjithshme e ponderuar)

Neni 5

Qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dytë

Qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dytë është thellimi i njohurive teorike dhe praktike të studentëve me studime dhe trajnime të avancuara dhe kërkimi shkencor në fushat, në të cilat ofrojnë programe studimi njësitë kryesore të Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër).

Në fund të programit, studentët do të jenë të aftë të ndërmarrin kërkime shkencore të vlefshme për specifikën shqiptare e ndërkombëtare.

Programet e studimit të ciklit të dytë janë konceptuar t’u ofrojnë studentëve jo vetëm informacionin më të fundit teorik, por edhe aspektin praktik, të bazuar në kërkimin shkencor bashkëkohor, në mënyrë që ata të plotësojnë njohuritë profesionale dhe t’i drejtojnë ata në përdorimin e njohurive që zotërojnë.

Neni 6

Struktura e programeve të ciklit të dytë


6.1. Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) ofron programe studimi të ciklit të dytë, në përfundim të të cilave lëshohet diploma “Master i shkencave”.

Kohëzgjatja normale e programeve të mësipërme është dy vite akademike, të ndarë në katër semestra me kohë të plotë, me jo më pak se 60 kredite ECTS në vit.

Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune.

Veprimtaria mësimore organizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, laboratorëve, projekteve të kërkimit, praktikës.

Kohëzgjatja e seancave mësimore është 60 minuta.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	3 / 24

Programet e studimit të ciklit të dytë të Fakultetit të Shkencave Humane marrin përsipër të ofrojnë studime të thelluara në fushat e mëposhtme:

Departamenti i shkencave islame ofron programet Master i shkencave (2 vite) në:

- Shkencat e shërbimeve shpirtërore
- Shkencat moderne islame
- Shkencat themelore islame

Departamenti i Drejtësisë ofron programet Master i shkencave në drejtësi (2 vite) në profilet:

- E drejta penale
- E drejta ndërkombëtare

Departamenti i Shkencave të Komunikimit ofron programet Master i shkencave në shkenca komunikimi(2 vite) në profilet:

- Marrëdhëniet me publikun
- Gazetari

Programet e studimit të ciklit të dytë të Fakultetit të Filologjisë dhe të Edukimit marrin përsipër të ofrojnë studime të thelluara në fushat e mëposhtme:

Departamenti i shkencave të edukimit ofron programet Master i shkencave:

- Në menaxhimin arsimor, planifikim dhe zhvillim kurrikule (2 vite)
- Në psikologji këshillimi (2 vite)

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze ofron programet Master i shkencave:

- Në gjuhë dhe letërsi angleze (2 vite)
- Në përkthim dhe interpretim (2 vite)


Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke ofron programet Master i shkencave:

- Në gjuhë dhe letërsi turke (2 vite)

6.2 Departamentet e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) ofrojnë programe studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilave lëshohet diploma Master profesional.

Kohëzgjatja normale e programeve të më sipërme është 1.5 vite akademike ose tre semestra me kohë të plotë, me jo më pak se 60 kredite ECTS në vit (30 ECTS në semestër).

Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	4 / 24

Veprimtaria mësimore organizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, laboratorëve, projekteve të kërkimit, praktikës.

Kohëzgjatja e orëve mësimore është 60 minuta.

Programet e studimit të ciklit të dytë të Fakultetit të Filologjisë dhe të Edukimit marrin përsipër të ofrojnë studime të thelluara në fushat e mëposhtme:

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë angleze ofron:

- Master profesional në mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm (1.5 vite).

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë turke ofron:

- Master profesional në mësuesi, gjuhë turke për arsimin e mesëm (1.5 vite).

KREU 2

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

Neni 7

Komiteti shkencor

Çdo departament zgjedh Komitetin shkencor për çdo program të studimit të ciklit të dytë, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Komiteti shkencor mban përgjegjësinë organizative për programin përkatës së ciklit të dytë.

Komiteti shkencor përcakton, gjithashtu, personelin tjetër akademik e ndihmës, me të cilin do të bashkëpunojë për realizimin e programit të studimit.

Komiteti shkencor përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimeve, programin e kërkimeve, kriteret e pranimit të studentëve. Komiteti përgatit çdo vit raportin e veprimtarive të programeve të studimit të ciklit të dytë.


Komiteti shkencor i propozon Këshillit të administrimit të fakultetit kuotat e studentëve për pranim në çdo vit akademik.

Neni 8

Personeli akademik

Personeli akademik, që zhvillon mësim në programet e studimit të ciklit të dytë, përbëhet nga stafi akademik që mban, të paktën gradën shkencore “Doktor”.

Pedagogët e huaj pranohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	5 / 24

Pedagogët e angazhuar në programet e studimit të ciklit të dytë kanë të drejtë:

- a) Të përdorin të gjitha mjediset dhe pajisjet e institucionit për veprimtari në dobi të programeve të studimit të ciklit të dytë.
- b) Të marrin pjesë në komisione dhe veprimtari të ndryshme të programeve të studimit të ciklit të dytë.
- c) Të kualifikohen në kuadrin e projekteve të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Pedagogët kanë për detyrë:

- a) Të zbatojnë rregulloren e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër).
- b) Të bashkëveprojnë dhe të krijojnë bashkëpunime me kolegët, studentët, bashkëpunëtorët e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit.
- c) Të realizojnë programin mësimor sipas kërkesave të përcaktuara.
- d) Të përmbushin përgjegjësitë për udhëheqjen e tezës.
- e) Të vlerësojnë studentët në mënyrë profesionale dhe në kohën e përcaktuar.

Neni 9

Bashkërenduesi i programeve të ciklit të dytë

Programet e ciklit të dytë drejtohen nga departamentet përkatëse.

Bashkërenduesi i programeve të ciklit të dytë emërohet nga senati akademik.

Detyrat e bashkërenduesit të programeve të ciklit të dytë:

- Bashkërendon punën e të gjitha programeve të ciklit të dytëbrenda IAL-së.
- Kontrollon dokumentacionin e studentëve dhe ia kalon për arkivim sekretarisë mësimore.
- Përpilon strukturën e formularëve të nevojshëm.
- Informon senatin akademik për mbarëvajtjen e programeve të ciklit të dytë.

Neni 10

Bashkërenduesi i programeve të ciklit të dytë


Çdo program i ciklit të dytë ka njëbashkërendues të veçantë, i zgjedhur nga Komiteti shkencor.

Në mungesë të tij ky funksion i ngarkohet përgjegjësit të departamentit.

Bashkërenduesi i programit ka detyrat e mëposhtme:

- I propozon këshillit të departamentit planifikimet e stafit akademik, për tu miratuar më pas nga Këshilli i fakultetit dhe nga Senati akademik.
- I raporton bashkërenduesit të programeve të ciklit të dytë për mbarëvajtjen e programit përkatës.
- Në bashkëpunim me udhëheqësin e kërkimit shkencor, ndjek mbarëvajtjen e punës këkimore të studentëve të programit përkatës.


Neni 11

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	6 / 24

Sekretari i programit të ciklit të dytë

Sekretari i departamentit është njëherësh edhe sekretar i programit të studimit të ciklit të dytë,
Sekretari për programin e studimit të ciklit të dytë ka detyrat e mëposhtme:

- a) Punon nën drejtimin e bashkërenduesit të programit dhe mban përgjegjësi për zbatimin e të gjitha porosive të dhëna prej tij, për komunikimin shkresor dhe gojor me organet e tjera të strukturës së brendshme të Shkollës me departamentet përkatëse, me personelin akademik, me studentët, me bashkëpunëtorët e Institucionit.
- b) Bën organizimin teknik të mbledhjeve të bashkërenduesit të programit dhe mban procesverbalin e mbledhjeve.
- c) Ndihmon në përgatitjen e materialeve për bashkërenduesin e programit.
- d) Merr në dorëzim letërkembimin dhe materiale të tjera që vijnë në adresë të bashkërenduesit të programit.
- e) Arkivon dokumentacionin e programeve të studimit të ciklit të dytë, të pedagogëve dhe të studentëve;
- f) Shtyp dhe shumëfishon shkresa dhe materiale mësimore.
- g) Ndjek ecurinë e procesit mësimor në lidhje me strukturën mësimore, orarin e lëndës e të provimeve, ecurinë e praktikës dhe mban dokumentacionin përkatës të këtyre proceseve.
- h) Afishon strukturën mësimore, orarin e lëndës, datat e provimeve, datat e praktikës, të mbrojtjes së tezave dhe njoftime për veprimtari të ndryshme.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	7 / 24

Neni 12

Sekretaria mësimore

Për realizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, sekretari mësimor përgjegjës për këto programe përgjigjet për detyrat e mëposhtme:

- a) Regjistron studentët e rinj për konkursin e pranimit, si edhe studentët e pranuar.
- b) Pajis të gjithë studentët e rinj të pranuar me kartë studenti, plotëson kërkesat e studentëve për vërtetime të thjeshta, listë notash e dokumente të tjera.
- c) Përgatit procesverbalet e vlerësimeve me emrat e studentëve dhe ia paraqet Komitetit shkencor për nënshkrim.
- d) Merr në dorëzim procesverbalet e plotësuar të vlerësimeve.
- e) Jep informacione për vlerësimin e studentëve.
- f) Hedh notat në regjistrin themeltar sipas kurseve dhe lëndëve, përgatit diplomat dhe transkriptet për studentët që përfundojnë studimet.
- g) Mban lidhje me dekanatin dhe Komitetin shkencor dhe raporton të dhënat statistikore të programeve të studimit të ciklit të dytë në instancat përkatëse.

Neni 13

Gjuha e programit të studimit

Në bazë të Statutit dhe Rregullores së Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë”(Bedër), programet e studimit të ciklit të dytë zhvillohen në gjuhën shqipe, angleze dhe turke. Përdorimi i një gjuhe tjetër në lëndë të veçanta lejohet me vendim të Komitetit shkencor dhe miratim të Këshillit të fakultetit dhe Senatit.

Neni 14

Kuotat e pranimit


Kuotat e pranimit të studentëve për programet e studimit të ciklit të dytë miratohen me vendim të Senatit në bazë të propozimit të Këshillit të administrimit të fakultetit, pasi është marrë mendimi i Komitetit shkencor për çdo program studimi.

Këshilli i administrimit të fakultetit vendos nëse do të hapë programet për atë vit akademik, kur ka më pak se gjashtë aplikime për programin përkatës.

Neni 15

Kriteret e pranimit

Të drejtën për të aplikuar për pranim e kanë të gjithë ata persona që zotërojnë një diplomë të nivelit të parë, të vlerësuar nga Shkolla, diplomë të nivelit të dytë, diplomë DIND, diplomë studimi të sistemit të mëparshëm, të pandarë në cikle studimi, a diplomë tjetër studimi universitar, të fituar jashtë vendit e barasvlerësuar nga ana e MASH.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	8 / 24

Kandidatët që aplikojnë për pranim, duhet të kenë marrë provimet e gjuhës së huaj të njohur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të ciat janë si më poshtë:

- a) TOEFL
- b) IELTS
- c) MICHIGAN TEST

Kandidatët që aplikojnë për programe, të cilat do të zhvillohen në gjuhën angleze, duhet të dorëzojnë certifikatat e gjuhës përpara se të fillojnë procesi mësimor. Kandidatët që pranohen në programet, të cilat nuk zhvillohen në gjuhën angleze, duhet të dorëzojnë certifikatën e gjuhës angleze së bashku me propozimin për tezën.

Kandidatët aplikojnë për t'u pranuar në programet Master i shkencave, duhet të kenë marrë nivelin A1.

Kandidatët aplikojnë për t'u pranuar në programet Master professional, duhet të kenë marrë nivelin B1.

Neni 16

Vlerësimi i pranimit

Pranimi i kandidatit kryhet në bazë të vlerësimit të rezultateve të studimeve universitare, të provimit të gjuhës së huaj, intervistës ose provimit të aftësive të veçanta. Në intervistë i kushtohet rëndësi letrës së motivimit për qëllimin e ndjekjes së studimeve të ciklit të dytë dhe certifikave të provimeve të standardeve ndërkombëtare.

Përzgjedhja e aplikuesve bëhet në rend zbritës nga rezultate më të larta në ato më të ulëta.


Për ata që janë me mesatare të barabarta, u jepet përparësi rezultateve të provimit të gjuhëve të huaja dhe pjesëmarrjeve në aktivitete akademike.

Studentët e diplomuar nga Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër) vlerësohen në bazë të rezultateve të studimeve universitare.

Neni 17

Vlerësimi i debive të formimit për programet Master shkencor

Studentët që zotërojnë diplomë të ciklit të parë, duhet të kryejnë vlerësimin e programit të studimit të cilin kanë ndjekur. Këshilli administrativ i fakultetit cakton Komitetin shkencor që të bëjë vlerësimin e diplomës së ciklit të parë. Në rast vlerësimi për debitë e formimit, studenti duhet të bëjë plotësimet e krediteve të mangëta në lëndët/fushat e nevojshme për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë. Numri maksimal i krediteve të mangëta për t'u plotësuar nuk mund t'i kalojë 45 ECTS.

 SHKOLLA E ARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	9 / 24

Në të njëjtën kohë, sipas legjislacionit në fuqi, Komiteti shkencor mund të njohë deri në 40 kredite të njohurive të veprimtarive formuese, të fituara më parë nga studenti, të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit.

Neni 18

Vlerësimi i debive të formimit për programet Master profesional

Studentët që zotërojnë diplomë të ciklit të parë, duhet të kryejnë vlerësimin e programit të studimit të cilin kanë ndjekur. Këshilli administrativ i fakultetit cakton Komitetin shkencor që të kryejë vlerësimin e diplomës së ciklit të parë. Në rast vlerësimi mbi debitë e formimit, studenti duhet të bëjë plotësimet e krediteve të mangëta në lëndët/fushat e nevojshme për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë. Numri maksimal i krediteve të mangëta për t'u plotësuar nuk mund t'i kalojë 20-30 kredite ECTS.

Në të njëjtën kohë, sipas legjislacionit në fuqi, Komiteti shkencor mund të njohë deri në 20-30 kredite të njohurive të veprimtarive formuese të fituara më parë nga studenti, të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit.

Neni 19

Pranimi i studentëve më status të veçantë


Në rast se studenti zotëron një diplomë sipasnenit 17 të kësaj rregulloreje dhe dëshiron të zgjerojë njohuritë e tij në një fushë të caktuar, me propozim të Komitetit shkencor dhe miratim të Këshillit të administrimit të fakultetit përkatës mund të ndjekë lëndë të veçanta, të ofruara në programin e studimit të ciklit të dytë, me cilësinë e studentit të veçantë. Këta studentë kanë të njëjtat të drejta si studentët e tjerë. Në përfundim, studenti pajiset me vërtetimin përkatës, në të cilën shënohet titulli i lëndës, vlerësimi, periudha e ndjekjes dhe pedagogu i lëndës.

Neni 20

Njoftimet

Çështjet që kanë të bëjnë me kriteret e pranimit, provimet dhe vlerësimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë përcaktohen nga Senati.

Lista e fituesve në programet e studimit të ciklit të dytë caktohet nga Komiteti shkencor, vendoset me vendim të Këshillit të administrimit të fakultetit dhe shpallet nga sekretari i fakultetit përkatës.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	10 / 24

KREU 3

REGJISTRIMI I STUDENTËVE DHE ORGANIZIMI I PROCESIT MËSIMOR

Neni 21

Regjistrimi në programin e studimit

Në rast se kandidati ka fituar të drejtën për të ndjekur programet e studimit të ciklit të dytë, detyrohet të zbatojë procedurat e regjistrimit, të parashikuara në këtë rregullore.

Regjistrimi bëhet sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në njoftimin e publikuar.

Kandidati që ka fituar të drejtën e regjistrimit, duhet të paraqesë pranë sekretarisë mësimore brenda afatit të caktuar në njoftim, dokumentet e mëposhtme:

1. Formular i plotësuar i aplikimit
2. Letër motivimi
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës së kandidatit ose e një dokumenti që vërteton diplomimin (diploma e universiteteve të huaja duhet të jetë e legalizuar me vulë Apostil)
4. Lista zyrtare e notave nga universiteti/institucioni i arsimit të lartë, ku tregohen të gjitha lëndët që studenti ka marrë, si edhe notat përkatëse
5. Dokumenti që dëshmon barasvlerësimin e diplomës në rast se kandidati ka përfunduar studimet në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit
6. Dëshmia e noterizuar e gjuhës së huaj
7. Fotokopje e letërnjoftimit (për kandidatët e huaj, fotokopja e noterizuar dhe e përkthyer në shqip e pasaportës)
8. Leja e qëndrimit e studentëve të huaj
9. 6 fotografi me përmasa 4,5x6 cm (fotografitë duhet të jenë me veshje të përshtatshme).

Neni 22


Pranimi i studentëve të huaj

Pranimi i studentëve të huaj në programet e studimit të ciklit të dytë bëhet sipas rregullave të mësipërme, por në raste të justifikuara, Komiteti shkencor përkatës mund të kërkojë edhe paraqitjen e dokumenteve të tjera.

Neni 23

Transferimet

Kuotat për transferimet brenda Shkollës apo nga jashtë saj përcaktohen nga Komiteti shkencor dhe miratohen nga Këshilli administrativ i fakultetit, sipas parimeve të vendosura nga ky Këshill.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	11 / 24

Studentëve, të cilët janë transferuar në programin e ciklit të dytë të studimeve u jepet diplomë me kusht që të kenë kryer, të paktën një semestër në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër).

Studentët e regjistruar në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), për t’u transferuar në një program tjetër brenda së njëjtës njësi kryesore të Shkollës, mund të aplikojnë në sekretarinë mësimore vetëm pasi të kenë kryer një semestër në një program të studimit të ciklit të dytë. Aplikimet duhet të kryhen brenda afateve të caktuara në kalendarin akademik, sipas parimeve të vendosura nga ana e Senatit.

Kërkesa shqyrtohet nga komiteti shkencor i programit ku kërkon të transferohet studenti, Këshilli administrativ i fakultetit merr vendim.

Neni 24

Statusi i studentit

Kandidati fitues ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik përkatës nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore brenda afateve të përcaktuara kur regjistrohet, studenti nënshkruan me Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) kontratën e shkollimit. Me regjistrimin ai fiton statusin e studentit dhe të gjitha të drejtat dhe detyrat që burojnë prej tij.

Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës ose me përjashtimin e personit nga programi i studimit.

Neni 25

Këshilltari


Këshilltari për çdo student emërohet me vendim të Komitetit shkencor, sipaspropozimit të bashkërenduesit të programit. Këshilltari e udhëzom studentin në lidhje me zgjedhjen e lëndëve dhe me projektin e sezonit. Këshilltari është pedagog i atij departamenti, me gradë shkencore “Doktor”.

Këshilltari udhëzon studentët që janë vlerësuar me debi në formim, në mënyrë që student të plotësojnë kreditet e mangëta në lëndët/fushat e nevojshme për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë.

Këshilltari udhëzon edhe për menaxhimin e karrierës së studentëve të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Neni 26

Regjistrimi i lëndëve

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	12 / 24

Studenti që vazhdon programet e studimit të ciklit të dytë në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) është i detyruar të kryejë regjistrimet e lëndëve që do të ndjekë gjatë semestrit, sipas parimeve të përcaktuara nga Komiteti shkencor. Përtëritja e regjistrimit bëhet në periudhat e përcaktuara në kalendarin akademik, përpara fillimit të çdo semestri.

Në rast se studenti nuk ka shlyer pagesën e studimit sipas kushteve të përcaktuara nga Institucioni, nuk mund ta përtërijë regjistrimin semestral. Studenti që nuk ka ripërtërirë regjistrimin, nuk mund të ndjekë mësimet dhe as të hyjë në provime.

Në rast se nuk përtërihet regjistrimi për dy semestra të njëpasnjëshëm, marrëdhëniet e studentit me Institucionin ndërpriten.

Lëndët e zgjedhura nga studenti për regjistrim duhet të miratohen më parë nga këshilltari.

Neni 27

Frekuentimi

Studenti i programit të ciklit të dytë ka detyrimin të ndjekë, të paktën 70% të aktiviteteve mësimore kërkimore, të zhvilluara në auditor të lëndëve teorike dhe të aktiviteteve mësimore kërkimore të zhvilluara në laboratorë e në praktikë. Studenti që tejkalon këto norma duhet ta rimarë të lëndë me të gjitha detyrimet përkatëse.

Plotësimi apo jo i kushteve në lidhje me pjesëmarrjen i paraqitet bashkërenduesit të programit nga ana e pedagogut të lëndës çdo muaj dhe kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit.


Neni 28

Kohëzgjatja e studimeve të ciklit të dytë

Kohëzgjatja normale e studimeve të programeve Master i shkencave është dy vite akademikë ose katër semestra dhe forma e studimit është me kohë të plotë. Kohëzgjatja maksimale e studimeve të ciklit të dytë është shtatë semestra nga regjistrimi fillestar. Në rast tejkalmi të këtij afati, Shkolla ndërpret marrëdhëniet me studentin. Studenti që është regjistruar në Shkollën e lartë me anë të transfertës dhe i është bërë njohje-njësimit lëndësh, mund t’i përfundojë studimet në një afat më të shkurtër kohor.

Kohëzgjatja normale e studimeve të programeve Master profesional është një vit e gjysmë akademik ose tre semestra dhe forma e studimit është me kohë të plotë. Kohëzgjatja maksimale e studimeve të ciklit të dytë është gjashtë semestra. Në rast tejkalmi të këtij afati, Shkolla ndërpret marrëdhëniet me studentin.

Neni 29

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	13 / 24

Viti akademik

Viti akademik përbëhet nga semestri i vjeshtës dhe i pranverës. Kohëzgjatja normale e semestrit të vjeshtës dhe të pranverës është 16 javë, përfshirë edhe javën e provimeve përfundimtare. Në raste të nevojshme, kohëzgjatja e tyre mund të shtyhet nga Senati i Shkollës.

Viti akademik organizohet në semestra me, së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratore në javë.

Fillimi i vitit akademik dhe kalendari i provimeve përcaktohet çdo vit nga Senati dhe publikohet. Në ditët zyrtare të pushimeve nuk bëhet mësim ose provime. Megjithatë, në rast se konsiderohet e nevojshme, me propozim të fakultetit përkatës dhe me miratim të Senatit, mësimi ose provimet mund të bëhen edhe në ditë të shtunë ose të diel.

Neni 30

Procesi mësimor (ngarkesa mësimore)

Programet e Masterit profesional përbëhen prej, së paku 10 lëndë, një lëndë seminar ose praktikë dhe punimi i tezës. Këto programe nuk mund të jenë më pak se 90 ECTS.

Programet e Masterit shkencor përbëhen prej, së paku 13 lëndë, një lëndë seminar ose praktikë dhe punimi i tezës. Këto programe nuk mund të jenë më pak se 120 ECTS.

Vlerësimi nga pikëpamja akademike për leksionet, aplikimet, laboratorët, projektet, seminarët, atelietë bëhet në bazë të njësisë matëse orë, të zhvilluar në auditor.

Studentët mund të zgjedhin jo më shumë se tri lëndë nga programi i ciklit të parë, me kusht që këto të mos i kenë marrë më parë.

Neni 31

E drejta për të hyrë në provim


Studenti fiton të drejtën për t'u futur në provimin e një lënde kur ka shlyer detyrimet që lidhen me të, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor.

Studentit i mohohet e drejta për të hyrë në provim, kur ka detyrime financiare.

Neni 32

Zhvillimi i provimeve

Niveli i përparimit të studentëve matet me anë të provimeve gjysmë-përfundimtare, provime përfundimtare, detyrave të kursit, projekteve e prezantimeve të cilat zhvillohen brenda semestrit të caktuar.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	14 / 24

Provimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen brenda afatit të përcaktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e tyre shpallen, të paktën dy javë përpara sezonit të provimeve.

Në rast pamundësie të zhvillimit të provimit ose të prezantimit ditën e caktuar, për rrethana të jashtëzakonshme, dekani me propozim të bashkërenduesit të programit dhe të pedagogut të lëndës, cakton me vendim një datë tjetër të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve dhe komisionit.

Lëndët e zhvilluara nga një pedagog vlerësohen vetëm prej tij. Kur lëndën e zhvillojnë disa pedagogë, të gjithë ata janë anëtarë të komisionit të vlerësimit.

Provimet përgatiten dhe drejtohen nga pedagogët që japin lëndën përkatëse. Në rast se pedagogu i lëndës nuk ndodhet në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) ditën e provimit, atëherë bashkërenduesi i programit përcakton sekush do të organizojë provimin.

Në rast se studenti nuk ka marrë pjesë në provimin gjysmë përfundimtar për shkaqe të justifikuara me shkrim brenda tri ditëve, mund të kryejë provimin make –up me vendim të departamentit dhe të këshillit të administrimit të fakultetit.

Neni 32

Ankimimi i rezultateve

Notat përfundimtare të lëndëve marrin formë të prerë në momentin që i dorëzohen përgjegjësit të departamentit përkatës dhe duhet të publikohen menjëherë.


Studentët kanë të drejtë të paraqesin brenda tri ditëve nga publikimi i notave të provimeve ose të notave përfundimtare, një kërkesë në sekretarinë mësimore, me anë të së cilës kërkojnë të rishikohet teza e provimit dhe të bëhet rillogaritja e notës.

Bashkërenduesi i programit së bashku me pedagogun e lëndës formojnë një komision prej tre vetash. Komisioni rishikon përgjigjen e provimit të studentit, nëse ka ose jo gabime gjatë vlerësimit dhe merr vendim. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim.

Neni 33

Përsëritja e lëndës

Në rast se studenti nuk plotëson kushtet e të qënit i suksesshëm në një lëndë, është i detyruar të përsërisë lëndën ose lëndën me të cilën është zëvendësuar në bazë të vendimit të departamentit përkatës.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	15 / 24

Studentët me qëllim përmirësimit e mesatares mund të përsërisin lëndët, apo lëndët e përcaktuara për të zëvendësuar atë lëndë, edhe pse kanë qënë të sukseshem në to. Vendimi për lejimin e përsëritjes merret nga Komiteti shkencor, me propozim të përgjegjës të departamentit.

Studentët që përsërisin lëndët jo për arsye të mungesave, nuk kanë detyrimin e pjesëmarrjes në atë lëndë, por duhet të marrin pjesë në treguesit që ndikojnë në notën përfundimtare.

Neni 34

Dokumentimi i vlerësimeve

Rezultatet pasqyrohen në procesverbalin e vlerësimit dhe në regjistrin e rezultateve. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretarinë e departamentit përkatës jo më vonë se dy javë nga dita e provimit ose e prezantimit të detyrës së kursit etj.

Në asnjë rast procesverbali i vlerësimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.

Procesverbali duhet të përmbajë nëshkrimin e pedagogut të lëndës dhe të sekretarit të departamentit.

Një vlerësim i raportuar mund të ndryshojë vetëm nëse rezulton se është bërë një gabim formal gjatë regjistrimit ose gjatë hedhjes në kompjuter. Personi përgjegjës për gabimin duhet të vëtojë me shkrim rrethanat e kryerjes së gabimit. Vërtetimi miratohet nga bashkërenduesi i programit. Ndryshimi pranohet brenda tri ditësh nga dita e konstatimit të gabimit.

Neni 35


Teza e diplomës

Studentifillon tezën e diplomës në semestrin e katërt. Teza e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite ECTS. Ajo ka vlerë jo më pak se 30 kredite ECTS.

Neni 36

Përgatitja dhe udhëheqja e tezës së diplomës

Programet e studimit Master profesional: Bashkërenduesi i programit përkatësi propozon Këshillit të fakultetit një udhëheqës teze për çdo student në fillim të semestrit të dytë dhe temën e tezës së përcaktuar nga udhëheqësi jo më vonë se fundi i semestrit të dytë.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	16 / 24

Programet e studimit Master shkencor: Bashkërenduesi i programit përkatës i propozon Këshillit të fakultetit një udhëheqës teze për çdo student në fillim të semestrit të tretë dhe temën e tezës së përcaktuar nga udhëheqësi jo më vonë se fundi i semestrit të tretë.

Udhëheqësi dhe tema e propozuar vendosen me vendim të Këshillit të administrimit të fakultetit. Ky i fundit mund të bëjë ndryshime për udhëheqësin dhe temën, a të caktojë një udhëheqës të dytë në rast se është e nevojshme.

Udhëheqësi i tezës përzgjidhet nga stafi akademik me të paktën gradën “doktor”.

Në rast se ka pa mjaftueshmëri në numër të këtij personeli të caktuar akademik, atëherë mund të zgjidhen nga personeli akademik i departamenteve të ngjashme, me të paktën gradën shkencore “doktor”.


Studenti duhet të regjistrojë tezën në fillim të semestrit të tretë. Studenti është i detyruar të kryejë regjistrimin për tezën e diplomës në atë periudhë që i ofrohet.

Neni 37

Përfundimi dhe vlerësimi i tezës


Përfundimi i tezës së programit të ciklit të dytë të studimeve kryhet si më poshtë:

- a. Studenti duhet ta përgatisë dhe ta shkruajë tezën në përputhje me rregullat e shkrimit, të përpiluara nga fakulteti dhe të miratuara nga Senati. Studenti e mbron tezën gojarisht përpara jurisë.
- b. Juria caktohet ose ndryshohet me vendim të Këshillit të administrimit të fakultetit sipas propozimit të departamentit. Këshilli i administrimit të fakultetit bën ndryshime në juri në rast se është e nevojshme.
- c. Juria përbëhet nga jo më pak se tre persona dhe një zëvendësues, një nga të cilët është udhëheqësi i tezës. Studenti duhet ta shumfishojë tezën e tij për çdo pjesëtar jurie dhe ua dorëzon dorazi apo me postë.
- d. Juri ambliohet jo më vonë se 30 ditë nga dorëzimi i tezës për të dëgjuar mbrojtjen e studentit.
- e. Kohëzgjatja e mbrojtjes së tezës është jo më pak se 45 minuta dhe jo më shumë se 90 minuta, duke përfshirë dhe pjesën e provimit me gojë pyetje-përgjigje. Juria bën të mundur praninë e një auditori gjatë mbrojtjes së tezës.
- f. Në përfundim të mbrojtjes së tezës, juria, me detyrë të mbyllura merr vendimin me shumicë absolute votash, për vlerësimin me notë dhe e komunikon vlerësimin e marrë. Departamenti njofton Fakultetin me anë të procesverbalit brenda tri ditësh nga marrja e vendimit.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	17 / 24

Studenti duhet të bëjë korrigjimet e nevojshme dhe të mbrojë tezën përsëri përpara të njëjtës juri brenda tre muajve, nëse merr vlerësimin jokalues. Nëse studenti vlerësohet me vlerësim jokalues përsëri, pavarësisht korrigjimeve të kryera për herë të dytë, atëherë marrëdhëniet midis tij dhe Shkollës së ndërpriten.

Studenti, që e ka kaluar me sukses mbrojtjen e tezës dhe i ka plotësuar të gjitha kushtet, duhet të dorëzojë në fakultetin përkatës tezën e shtypur dhe të lidhur në katër kopje dhe në formë elektronike. Studenti duhet ta dorëzojë tezënjo më vonë se një muaj që nga data e mbrojtjes së saj.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	18 / 24

KREU 4 VLERËSIMI I STUDENTIT

Neni 38 Vlerësimet

Vlerësimi sasior i punës së studentëve në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) kryhet me anë të krediteve sipas sistemit amerikan dhe atij ECTS, të llogaritura sipas metodologjisë së përmendur në nenet e kësaj rregulloreje.

Vlerësimi cilësor i punës së studentëve kryhet me anë të notave. Vlerësimi me notë i lëndëve dhe i tezës së diplomës të programit të studimit të ciklit të dytë kryhet sipas tabelës së mëposhtme:

*Pikë	Nota sipas sistemit shqiptar i	Nota Shkronjore	Koeficient	Shpjegimi
90-100	10	A	4,00	I suksesshëm
85-89	10	A-	3,66	I suksesshëm
80-84	9	B+	3,33	I suksesshëm
70-74	8	B-	3,00	I suksesshëm
65-69	7	C+	2,33	Në provë
60-64	7	C	2,00	Në provë
55-59	6	C-	1,66	Jokalues
50-54	5	D+	1,33	Jokalues
45-49	5	D	1,00	Jokalues
40-44	4	D-	0,66	Jokalues
0-39	0	F	0	Jokalues
NA	0	NA	0	Mosfrekuentim i lëndëve/ Jokalues

*Sistemi 0-100 pikë.

Nota që nuk llogariten në mesatare:

I- Me mangësi

S- Mjaftueshëm

T- Transferuar


U- Pamjaftueshëm

P- Në vijim

EX- Përrjashtuar nga detyrimi

NI- Nuk përfshihet

NA - Nuk ka marrë pjesë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	19 / 24

Rastet e përdorimit dhe shpjegimi i notave-shkronja:

Nota I jepet nga pedagogu i lëndës për atë student, i cili për shkak të një sëmundjeje ose të ndonjë shkakut tjetër të arsyeshëm, nuk ka mundur të plotësojë kërkesat e lëndës, edhe pse ka qenë i suksesshëm gjatë semestrit. Në rast se studenti ka marrë në një lëndë të caktuar notën I, ai është i detyruar që brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore të plotësojë mangësitë, në mënyrë që të marrë një notë. Nota që e cila do të jepet në vend të notës I miratohet me vendim të Këshillit të administrimit të fakultetit. Përndryshe, nota I shndërrohet në notën F. Megjithatë, në rastet e një sëmundjeje të gjatë ose në raste të ngjashme, me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe me miratim të Këshillit të administrimit të fakultetit, kohëzgjatja e notës I mund të vazhdojë deri në fillimin e periudhës së regjistrimeve në semestrin pasardhës.

Nota S i jepet studentit në lëndët, në të cilat ai ka qenë i suksesshëm, por që nuk llogariten në mesatare.

Nota T jepet në rastet e transferimit horizontal nga një institucion tjetër i arsimit të lartë ose në rastet kur pranohet rezultati i një lënde të kaluar, barasvlershmëria e së cilës pranohet me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe me miratim të Këshillit të administrimit të fakultetit.

Nota T nuk merret parasysh në llogaritjen e mesatares.


Për lëndët e marra gjatë programeve të shkëmbimit të studentëve, Këshilli administrativ i fakultetit përkatës vendos në lidhje me barasvlershmerinë e krediteve dhe të notave (të marra në këto lëndë).

Nota U i jepet studentit në lëndët në të cilat ai ka qenë i pasuksesshëm, por që nuk llogariten në mesatare.

Nota P i jepet studentit në lëndët në vazhdim, të cilat nuk llogariten në mesatare.


Nota EX i jepet studentit, i cili përjashtohet nga marrja e një lënde në vijim të një provimi të organizuar nga departamenti në ato lëndë të përcaktuara nga ana e Senatit. Studentit në fjalë nuk i njihen kredite nga lënda e marrë. Nota EX nuk llogaritet në mesatare, por pasqyrohet në listën e notave.

Nota NI jepet për të përshkruar lëndët në të cilat është regjistruar studentit, por që nuk llogariten në mesataren e notave. Kjo notë paraqitet në listën e notave të studentit së bashku me notën-shkronjë që ai ka marrë në atë lëndë. Ngarkesa e lëndëve të cilat kanë këtë status përfshihen në

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	20 / 24

grupin e lëndëve të përcaktuar në nenin 14 dhe nuk përdoren në procedurat e përllogaritjes së lëndëve të programit ose programeve, në të cilat studenti është i regjistruar. Lënda në të cilën studenti ka marrë notën NI, nuk mund të përsëritet.

Nota NA i jepet nga pedagogu përkatës i lëndës studentit i cili për shkak se nuk ka zbatuar rregullat në lidhje me frekuentimin e lëndës ose nuk ka plotësuar kërkesat në lidhje me praktikën ose aplikimin e lëndëve, ka qënë i pasuksesshëm. Në llogaritjen e mesatares, nota NA koniderohet si F.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	21 / 24

Neni 39

Vlerësimi i notës së suksesshme dhe mesatarja

Nëse në një lëndë studenti vlerësohet me B- (3.00) ose me një notë më të lartë, ai është i suksesshëm. Nëse në një lëndë studenti vlerësohet me C (2.00), ai është në status prove.

Në rast se në një lëndë studenti vlerësohet me notë më të ulët se C (C-, D+, D, D- dhe F), ai është jokalues dhe është i detyruar të përsërisë lëndën.

Në rast se mesatarja e përgjithshme e notave është të paktën (3.00) dhe nuk ka note-shkronjë C-, D+, D, D- dhe F, studenti quhet i suksesshëm.

Në rast se mesatarja e përgjithshme e notave është më pak se 3.00, studenti merr statusin e provës. Studenti që ndodhet në statusin e provës, duhet që të përsërisë lëndët, në të cilat ka qënë pa suksesshëm në semestrat e mëparshëm. Në këtë rast, studenti nuk duhet të marrë asnjë notë C-, D+, D, D- dhe F.

Studenti duhet të ketë mesatare të përgjithshme B- (3.00); në të kundërt nuk fiton të drejtën e diplomimit.

Neni 40

Mesatarja e përgjithshme e notave

Mesatarja e përgjithshme e notave nxirret nga shumëzimi i notës përfundimtare të marrë nga lënda ose nga laboratorit, projektet, atelietë, seminarët ose punët e ngjashme, që kanë vlerën e një lënde me orët e krediteve të lëndës përkatëse dhe shuma qëdel, pjesëtohet me shumën e përgjithshme të krediteve. Shuma që del nga pjesëtimi rrumbullakoset me dy shifra pas presjes dhe përbën mesataren e përgjithshme të notave.

KREU 5


STUDENTËT

Neni 41

Të drejtat e studentëve

Studentët e programeve të studimit të ciklit të dytë kanë këto të drejta:

- Të udhëhiqen nga rregulla dhe procedura të formuluara qartë dhe të justifikuara në aspektin akademik.
- Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik.
- Të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon për të gjitha çështjet akademike dhe veprimtarinë e programeve të studimit të ciklit të dytë.
- Të përdorin pajisjet e Institucionit sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre shkencor, bibliotekën dhe internetin.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	22 / 24

- Të paraqesin lirisht pikëpamjet e tyre.
- Të marrin pjesë në vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe profesionale të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Neni 42

Përgjegjësitë e studentëve

Studentët e programeve të studimit të ciklit të dytë kanë këto përgjegjësi:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregulloren e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), kërkesat e planit dhe të programeve mësimore dhe të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre. Në të kundërt institucioni nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- Të kenë sjellje dhe qëndrime etike, profesionale e qytetare në tërë marrëdhëniet me drejtuesit, personelin akademik e administrativ dhe studentët.
- Të përmbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e programeve mësimore të praktikës dhe të tezës.
- Të kontribuojnë në realizimin e suksesshëm të programeve të studimit të ciklit të dytë dhe në krijimin e një klime pozitive në Institucion.
- Të paguajnë taksën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit në afatet e caktuara.
- Të mbajnë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të programeve të studimit të ciklit të dytë nga ana e tyre. Dëmi material që mund t’i shkaktojë Institucionit zhdëmtohet në masën që e gjykon administrata e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër).

Masat disiplinore për studentët, në rast shkelje parashikohen në Rregulloren “Për Disiplinën e Studentëve në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër).


Neni 43

Pezullimi i statusit të studentit

Studenti i regjistruar, në rast plotësimi të shkaqeve të arsyeshme të parashikuara më poshtë, mund të pezullohet nga statusi i studentit. Ai ka të drejtë të vazhdojë sërish procesin mësimor në një kohë të mëvonshme, të gjykuar të përshtatshme nga Këshilli administrativ i fakultetit. Studenti mund të paraqesë kërkesë për marrje leje për shkaqe të arsyeshme brenda 30 ditëve nga fillimi i vitit akademik. Kjo leje duhet të miratohet nga Këshilli administrativ i fakultetit. Studentit mund t’i jepet leje deri në dy semestra.

Shkaqet e arsyeshme janë si më poshtë:

- a) Në rast se rivendoset detyrimi për shërbim ushtarak ose hiqet shtyrja për të kryer shërbimin ushtarak, pavarësisht pozicionit në të cilin ndodhet studentit;

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	23 / 24

- b) Në rast sëmundjeje, katastrofash natyrore, arrestimi sipas rasteve të parashikuara në rregulloren “Për disiplinën e studentit” të Shkollës, shkaqesh ekonomike, të cilat cilësohen si shkaqe të përshtatshme dhe të justifikuara nga Këshilli administrativ i fakultetit, studentit mund t’i jepet leje edhe brenda semestrit. Në këtë rast, studentit nuk i kthehet pagesa mësimore e shlyer nga ana e tij.
- c) Në rast mungesash për arsye “skizofrenie të lehtë, skizofrenie paranoiake, sindromës diasociative, rasteve borderline” të vërtetuara më dokument zyrtar.

Studenti që kërkon leje në kushtet e parashikuara në pikën b, duhet t’i drejtohet sekretarisë mësimore brenda 20 ditëve nga data e ngjarjes dhe të paraqesë dokumentet që provojnë ekzistencën e faktit. Në rast se shkaqet në fjalë vazhdojnë, Këshilli i administrativ i fakultetit mund të vendosë zgjatjen e lejes .

Lejet afatgjata nuk përfshihen në kohëzgjatjen e shkollimit me kusht që ky fakt të jetë parashikuar në vendimin e Këshillit administrativ të fakultetit.

Neni 44

Semestri i verës

Shkolla mund të hapë lëndë në semestrin e verës me propozim të bashkërenduesit të programit dhe me vendim të Këshillit të administrimit të fakultetit. Studentët i marrin lëndët e miratuara nga këshilltari përkatës.

Neni 45

Largimi nga programi


Studenti që dëshiron të largohet nga programi i studimit me dëshirën e vet, duhet t’i drejtohet me shkresim Komitetit shkencor të programit, ku ndjekstudimet. Studenti çregjistrohet pas paraqitjes së dokumentit që dëshmon se nuk ka asnjë detyrim ndaj njësive përkatëse të Shkollës me vendim të Këshillit administrativ të fakultetit. Studenti që është çregjistruar mund të kërkojë një dokument për arsimin e ndjekur deri në atë moment. Në të njëjtën kohë, atij i kthehen diplomat dhe dokumentet e tjera të dorëzuara prej tij në momentin e regjistrimit në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)..

KREU 6

VLERËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

Neni 46

Vlerësimi i cilësisë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-017-AL	01.10.2012	0	0	24 / 24

Programet e studimit të ciklit të dytë kryejnë në fund të çdo viti vlerësimin e brendshëm dhe kërkojnë akreditimin në afatet e parashikuara me ligj.

KREU 7

DOKUMENTET VLERËSUESE

Neni 47

Diploma

Studenti që përfundon me sukses lëndët me kredite dhe tezën e diplomës ka grumbulluar 120 kredite ECTS, pajiset me diplomë të studimeve të ciklit të dytë, Master i shkencave.

Studenti që përfundon me sukses lëndët me kredite dhe tezën e diplomës dhe ka grumbulluar 90 kredite ECTS, pajiset me diplomë të studimeve të ciklit të dytë, Master profesional.

Në diplomën e studimeve të ciklit të dytë shënohet programi dhe titulli i propozuar nga Komiteti shkencor i programit, emërtimi i programit, departamenti dhe fakuleti në të cilin është ndjekur programi i studimit.

Neni 48

Suplementi i diplomës

Diploma e studimeve të ciklit të dytë shoqërohet nga suplementi i diplomës, përmbajtja dhe forma e të cilës përcaktohet nga Senati, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Suplementi i Diplomës përmban natyrën, nivelin e studimeve, përmbajtjen, rezultatet e studentit dhe rregulla të tjera të përcaktuara nga Senati i Shkollës në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

KREU 8

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 49

Zbatimi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj në Këshillin e lartë. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga rektori.